



TEATRI I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

LIBRETI MUJOR – DHJETOR 2022



PREZANTOHET KALENDARI ARTISTIK 2023 ME PLOT RISI E KRYEVEPRA TË NJOHURA BOTËRORE

Drejtoresha e Përgjithshme e Teatrit të Operës dhe Baletit, Abigeila Voshtina, prezantoi **Kalendarin Artistik 2023** për artistët, kompozitorët, ambasadorët, përfaqësuesit e institucioneve dhe të gjithë artdashësit.

Ky program **i pasur dhe ambicioz** që do të përmbajë tituj të veprave që vijnë për herë të parë në Shqipëri, **kryevepra të Verdi-t**, duke iu bashkuar kështu "Vitet Verdian", si dhe programe edukative si **"Opera & Fëmijët"** apo **ajo e "Masterclass-it"**, të ngritur në kuadër të bashkëpunimeve ndër-institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare, ka si qëllim **rritjen e cilësisë artistike** dhe pasurimin e kulturës sonë.

Kalendari vjetor u krijua nga një **punë intensive me Bordin Honorifik Drejtues** dhe gjithë përfaqësuesit e sektorëve të TKOB-së, për të ndërtuar një **produkt efikas artistik** dhe maksimizuar përfshirjen e grupmohave të ndryshme.

NË PRITJE TË "VITIT VERDIAN" MBAHET GRAND GALA-JA "ASPETTANDO VERDI"

Me një program të jashtëzakonshëm që nisi me "La Forza del Destino" dhe bëri bashkë veprat e Verdi-t, Offenbach-it, Rossini-t, Puccini-t, Donizetti-t dhe Cilea-s, u celebrua mahnitshëm **Gand Gala-ja "Aspettando Verdi"**, në Teatrin e Operës dhe Baletit (TKOB), më 27 dhjetor.



Harmonia shpresëdhënëse e **kryeveprave klasike të Verdi-t**, që shkrijnë traditat më të bukura të operës italiane, interpretuar nga **solistë e TKOB-së**, erdhi këndshëm në këtë fundvit, për kënaqësinë e veçantë të personaliteteve publike, elitës politike, sociale e kulturore, artistëve, kompozitorëve, muzikantëve dhe të gjithëve artdashësve shqiptarë e të huaj.

Në pritje të Vitit të Ri 2023, TKOB i bashkohet teatrove të tjerë përreth globit **në shpalljen e 2023-it si "Viti Verdian"**, me rastin e 210-vjetorit të vdekjes të kompozitorit, Giuseppe Verdi.



Teatri Kombëtar i Operës,
Baletit dhe Ansamblit Popullor



Teatri i Operës dhe Baletit

ARTISTËT E TKOB-SË MIRËPRESIN LIDERËT EVROPIAN ME VALLE TRANDICIONALE E SHFAQJE OPERISTIKE, NË SAMITIN BE- BALLKANI PERËNDIMOR

Liderët evropianë dhe ato të rajonit, para nisjes zyrtare të **Samitit BE- Ballkani Perëndimor** u mirëpritën **me larmi vallesh popullore dhe shfaqje operistike** nga artistët profesionistë të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor, më 6 dhjetor. Ky samit, që u mbajt për herë të parë në zemër të rajonit, Shqipëri, shërbeu edhe **për të treguar traditën e vyer shqiptare dhe vlerat e çmuara kulturore** që synojmë t'i integrojmë në bashkësinë evropiane.

Pjesë e kësaj performance ishin **artistë nga Grupi i Ansamblit Popullor, korit, balerinëve, solistëve, grupit të Ansamblit Tiranë, nxënësve dhe mësuesve të shkollës së baletit, grupit të “Jar Gorences”,** të cilët sollën kërcime me motive të ndryshme nga treva shqiptare, si ato nga veriu i Shqipërisë ashtu edhe nga jugu apo Shqipëria e Mesme.



KREMTOHET XHUBLETA SI PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE JO-MATERIALE NËN MBROJTJEN E UNESCO-S

Mbrëmjen e 20 dhjetorit u kremtua **Xhubleta, pasuri kombëtare shqiptare që u shpall zyrtarisht si pasuri e gjithë njerëzimit**. Ky aktivitet u organizua pranë Pallatit të Brigadave, nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Kulturës, ku mori pjesë dhe drejtoresha e Përgjithshme e Teatrit të Operës dhe Baletit, Abigeila Voshtina, për të përfaqësuar artistët e Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Vlerë e shtuar e kësaj ceremonie ishin dhe **zonjat e vajzat e vogla nga Malësia e Madhe,** të veshur nën hijeshinë e xhubletës.

Pas një pune të gjatë dhe plot përkushtim të një grupi të madh bashkëpunëtorësh, **Xhubleta, aftësitë, mjeshtëria dhe format e përdorimit janë përfshirë tashmë në listën e Trashëgimisë Kulturore Jo-materiale nën mbrojtjen e UNESCO-s** dhe vjen si dhuratë për 110-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Xhubleta, kryevepra që mbart historinë e fisnikërisë së arbrit, ka përcjellë për shekuj me radhë **kulturën tonë, atdheadashurinë dhe shpirtin hyjnor shqiptar deri në adhurim.**





"LA TRAVIATA" E VERD-IT SHËNJON FILLIMIN E RRUGE TË GJATË BASHKËPUNIMESH MES OPERËS SË SHQIPËRISË DHE ASAJ TË KOSOVËS

Instrumentistët e Teatrit të Operës dhe Baletit dhe **tenori Denis Skura** performuan si asnjëherë më parë, bashkë me artistët e Operës së Kosovës, për një nga **shfaqjet operistike të përmasave të mëdha, "La Traviata" e Verd-it.**

Përmes një energjie të jashtëzakonshme, për një publik të veçantë artdashësish, kjo kryevepër u soll më 17 dhjetor, në bashkëpunim me **Operën e Kosovës, Operën Shtetërore të Stara Zagorës në Bullgari, Filharmonisë së Kosovës dhe Baletit Kombëtar të Kosovës.** "La Traviata" shënjoi dhe **fillimin e një rruge të gjatë bashkëpunimesh** mes operës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës!



RIKTHEHET PËR ARTDASHËSIT KRYEVEPRA E DONIZETTIT "DON PASQUALE"

Nga **3 kaste** të palodhur profesionistësh, me **4 net shfaqje** për publikun shqiptar dhe jo vetëm u rikthyer në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit (TKOB), **pas 64 vitesh, vepra "Don Pasquale" e Gaetano Donizetti.** Kjo erdhi si një premierë e rikonceptuar në dimensione të reja regjisoriale, **përgatitje të posaçme vokale** për solistët dhe shprehje e gjeneratës së re premtuese dhe të ardhmes së operës shqiptare.

Vepra u vu **për herë të parë në skenë, më 11 korrik të vitit 1959,** me regji të M.G Gevorkian, dirigjent, Simon Gjoni, piktor, Shadan Toptani, dhe me solistët e njohur: Haxhi Tafaj, Hysen Pelinku, Avni Mula, Kristaq Antoniu, Mihal Ciko, etj.. Të tilla vepra të rikthyer në skenë pas disa dekadash formojnë **një gjeneratë artistësh të çmuar** që ndërtojnë mes tyre ura të forta për krijimin e një shoqërie më të mirë.



TRAJNOHEN ME PROFESIONALIZËM SOLISTËT E TKOB-SË NË MASTERCLASS-IN E ELDA LARO NË SHQIPËRI DHE PROFESORËT E "MASCARADA OPERA STUDIO" NË ITALI.

Pianistja dhe dirigjentja e stafit në prestigjiozen "Deutsche Oper" të Berlinit, Elda Laro, trajnoi me profesionalizëm solistët e Teatrit të Operës dhe Baletit **për shfaqjen "Don Pasquale" dhe "Elsiri D'Amore".** Nëpërmjet bashkëpunimit me figura të shquara të muzikës, në shtëpinë kryesore operistike të vendit, artistët gëzuan perspektivën unike **të përkthimit në praktikë profesionale në skenë, të asaj që kanë mësuar.**

Gjithashtu, 3 solistët e TKOB-së, soprano Rovena Xhelili, bass-at Bledar Domi e Xhieldo Hyseni zhvilluan **në Firenze të Italisë, masterclass-in me profesorët e "Mascarada Opera Studio",** në kuadër të bashkëpunimit me "RLIOF Festival". Artistët patën mundësinë të punojnë së bashku me **këngëtarë të njohur, trajnerë, konsulentë zëri dhe drejtorë të skenës,** për të përmirësuar aftësitë e tyre teknike dhe për të eksploruar identitetet e tyre artistik. Qasja që Shqipëria po tregon në fushën e artit i **tejkalon kufijtë historik të rajonit,** duke promovuar dhe fuqizuar akoma më tepër vlerat tona artistike!